



Masat mbrojtëse për emigrantët e parregullt të privuar nga liria

*Pjesë nga raporti i 19-të i Përgjithshëm,
publikuar në vitin 2009*

Vërejtje paraprake

75. Në pjesën substantive të Raportit të 7-të të Përgjithshëm, të botuar më 1997, KPT përshkruan në hollësi pozicionin e vet lidhur me masat mbrojtëse dhe kushtet për shtetasit e huaj të privuar nga liria në bazë legjislacionit për të huajt ("të ndaluarit e imigracionit"), si dhe pikëpamjet e veta lidhur me dëbimin e personave të tillë.¹ Ndërkohë në një numër vendesh KPT-ja ka kryer vizita të shpeshta nëpër qendrat e paraburgimit të dedikuara për imigracion si dhe në stacione policore dhe burgje, ku vazhdojnë të mbahen të ndaluarit e imigracionit. Këto vizita, shumë shpesh, kanë të përforcuar mendimin e Komitetit se të ndaluarit e imigracionit janë veçanërisht të ekspozuar ndaj formave të ndryshme të keqtrajtit, qoftë në momentin e arrestimit, gjatë periudhës së ndalimit ose edhe kur deportohen.

Duke pasur parasysh natyrën e ndjeshme e këtij grupi të personave, KPT-ja, në vazhden e shumë vizitave, ka përqendruar vëmendjen e vet te trajtimi i të ndaluarve të imigracionit. Për më tej, Komisioni ka vazhduar të zhvillojë standardet e veta, për shembull duke e elaboruar në Raportin e 13-të të Përgjithshëm të udhëzimeve për deportimin e shtetasve të huaj nëpërmjet ajrit, duke i përfshirë të ndaluarit e imigracionit.²

76. Në Raportin e Përgjithshëm të 19-të, KPT-ja po i parashton pikëpamjet e veta mbi masat mbrojtëse që duhen ofruar për emigrantët e parregullt që ndalohen, me një theks shtesë të veçantë për fëmijët.³ "Emigrantët e ndaluar të parregullt" është termi i përdorur për personat që janë privuar nga liria në bazë të legjislacionit për të huaj ose për shkak se kanë hyrë në një shtet në mënyrë të paligjshme (ose kanë tentuar të hyjnë), ose sepse kanë mbetur përtej lejeqëndrimit të tyre ligjor për të qenë në shtetin në fjalë.

Duhet të theksohet se azilkërkuesit nuk janë emigrantë të parregullt, edhe pse personat në fjalë mund të bëhen të tillë nëse kërkesa për azil u refuzohet dhe leja për të qëndruar në një shtet u shfuqizohet. Sa herë që azilkërkuesit privohen nga liria në pritje të rezultatit të aplikimit të tyre, atyre duhet t'u jepet një gamë e gjerë masash të sigurisë në përputhje me statusin që kanë, duke

¹ Shih paragrafët 24 deri në 36 të dok. CPT/Inf (97) 10.

² Shih paragrafët 27 deri 45 të dok. CPT/Inf (2003) 35.

³ Kjo nuk sugjeron se fëmijët janë grupi i vetëm i preکشëm. Të moshuarit dhe gratë e pashoqëruara, për shembull, janë gjithashtu të preکشme.

shkuar përtej masave që zbatohen për emigrantët e parregullt që përcaktohen në paragrafët e mëposhtëm.⁴

Privimi nga liria i emigrantëve të parregullt

77. Në vazhden e vizitave të KPT-së është vërejtur se një numër shtetesh anëtare të Këshillit të Evropës kanë bërë përpjekje të bashkërenduar për t'i përmirësuar kushtet e ndalimit për emigrantët e parregullt. Megjithatë, ende ka shumë raste ku KPT-ja përballet me vende privimi të lirisë për emigrantët e parregullt, dhe me raste edhe të azilkërkuesve, të cilat janë krejtësisht të papërshtatshme. Një shembull ilustrues i një vendi të tillë do të ishte ndonjë depo e vjetër, me pak kanalizime ose pa to fare, e mbushur me shtretër ose dyshekë mbi dysheme, që akomodon mbi njëqind persona të mbyllur së bashku për javë ose edhe muaj të tërë, pa aktivitete, pa qasje në stërvitje në natyrë e me higjienë krejt të dobët. Delegacionet e KPT vazhdojnë të gjejnë edhe emigrantë të parregullt që mbahen në komisariatet e policisë, në kushte që mezi janë të pranueshme për njëzet e katër orë, e jo më për disa javë.

Në disa shtete, emigrantët e parregullt janë të arrestuar në burgje. Sipas mendimit të KPT-së, burgu sipas përkufizimit nuk është vend i përshtatshëm në të cilin të mbahet dikush që as nuk është as i akuzuar as i dënuar për ndonjë vepër penale. Megjithatë, drejtuesit e burgut dhe stafi në institucione të ndryshme të vizituara nga KPT-ja, shpesh pajtohen se nuk janë të pajisur as të trajnuar si duhet për t'u kujdesur për emigrantët e parregullt. Në këtë kontekst, KPT dëshiron të përsërisë se personeli që punon në qendrat për emigrantët e parregullt ka një detyrë veçanërisht të vështirë. rrjedhimisht, ata duhet të përzgjidhen me kujdes dhe të marrin trajnimin e duhur.

78. Pavarësisht nga ekzistenca e objekteve të shumta të paraburgimit për emigrantët e parregullt në vendet anëtare të Këshillit të Evropës, ende nuk ka një instrument gjithëpërfshirës që mbulon gjithë kontinentin evropian⁵ e që përcakton standardet minimale dhe masat mbrojtëse për emigrantët e parregullt të privuar nga liria, në përputhje me nevojat specifike të këtij grupi të caktuar të personave.

Rregullat Evropiane të Burgjeve të vitit 2006 vlejnë për ata emigrantë të parregullt që mbahen në burgje. Megjithatë, theksohet në Komentimin e Rregullave që të ndaluarit e imigracionit në parim nuk duhet të mbahen në burgje. Prandaj, Rregullorja nuk i adreson nevojat e veçanta dhe statusin e emigrantëve të parregullt, si çështjet që lidhen me përgatitjen dhe ekzekutimin e procedurave të deportimit. Duhet të theksohet këtu se në përputhje me Nenin 5 (1)f të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, emigrantët e parregullt mund të privohen nga liria e tyre ose kur ndërmerren veprime me qëllim të deportimit ose për ta parandaluar hyrjen e paautorizuar në shtet. Qëllimi i privimit të lirisë të emigrantëve të parregullt është prandaj shumë i ndryshëm nga ai i personave të mbajtur në burgje ose në paraburgim a si shkelës të dënuar.

⁴ Për azilkërkuesit, masat mbrojtëse të caktuara ndërkombëtare e kanë origjinën nga Konventa e Gjenevës e vitit 1951 lidhur me Statusin e Refugjatëve dhe Protokollin e saj të vitit 1967. Për më shumë, legjislacioni i Bashkimit Evropian, në Direktivën e veçantë të Këshillit 2003/9/EC të datës 27 janar 2003 që përcakton standardet minimale për pritjen e azilkërkuesve, ka caktuar një numër garancish; megjithatë, zbatimi i këtij legjislacioni është i kufizuar në shtetet anëtare të BE-së. Referenca duhet të bëhen edhe për Udhëzimeve për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në kontekstin e procedurave të përsheptuara të azilit, të miratuara nga Këshilli i Ministrave i Këshillit të Evropës më 1 korrik 2009.

⁵ Direktiva 2008/115/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të Bashkimit Evropian e datës 16 dhjetor 2008 mbi standardet dhe procedurat e përbashkëta në Shtetet Anëtare për kthimin e shtetasve të paligjshëm që qëndrojnë në vendet e treta parashtron, ndër të tjera, standardet që lidhen me migrantët e parregullt të privuar nga liria. Direktiva është e zbatueshme në shumicën e shteteve anëtare të BE-së dhe në disa vende të tjera dhe duhet të transpozohet në legjislacionin shtetëror deri në fund të vitit 2010.

79. Kushtet e ndalimit për emigrantët e parregullt duhet ta reflektojnë natyrën e privimit të tyre nga liria, me kufizime të limituara në vend dhe një regjim të llojllojshëm të aktiviteteve. Për shembull, emigrantët e parregullt të paraburgosur duhet të kenë çdo mundësi që të mbeten në kontakt të plotë me botën e jashtme (përfshirë këtu mundësitë e shpeshta për të bërë thirrje telefonike dhe pranuar vizita), dhe liria e tyre e lëvizjes brenda institucionit të paraburgimit duhet të kufizohet sa më pak. Edhe kur kushtet e paraburgimit në burgje i përmbushin këto kërkesa - dhe sigurisht nuk është gjithmonë kështu - KPT e konsideron paraburgimin e emigrantëve të parregullt në një ambient burgu si thelbësisht të gabuar, për arsytet e shënuara më lart.

80. Në përgjithësi, në disa vende, autoritetet në mënyrë rutinore përdorin paraburgimin administrativ të emigrantëve të parregullt në pritje të deportimit, ndonjëherë pa kufizim kohor apo shqyrtim gjyqësor. Është e qartë se ndalimi automatik administrativ nën kushte të tilla bart rrezikun e të qenit në kundërshtim me, jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut ndër të tjera. Sipas mendimit të KPT-së, shtetet duhet të jetë përzgjedhëse kur ushtrojnë fuqinë e tyre për t'i privuar emigrantët e parregullt prej lirisë së tyre; paraburgimi duhet të përdoret vetëm pas një shqyrtimi të kujdesshëm të çdo rasti individual.

Të drejtat themelore në fazat fillestare të privimit të lirisë

81. KPT konsideron se emigrantët e parregullt të paraburgosur duhet, që nga fillimi i privimit të tyre nga liria, t'i gëzojnë tri të drejta themelore, njëlloj si kategoritë e tjera të personave të ndaluar. Këto të drejta janë: (1) të kenë qasje në një avokat, (2) të kenë qasje në një mjek, dhe (3) të jenë në gjendje ta informojnë një të afërm apo person të tretë sipas zgjedhjes së vet rreth masës së paraburgimit.

82. E drejta e qasjes në avokat duhet të përfshijë të drejtën për të folur me një avokat privatisht, si dhe për të pasur qasje në këshilla ligjore për çështje që lidhen me qëndrimin, ndalimin dhe deportimit. Kjo nënkupton se kur emigrantët e parregullt nuk janë në gjendje të caktojnë dhe të paguajnë një avokat vetë, ata duhet të përfitojnë nga qasja në ndihmë juridike.

Për më tej, të gjithë të paraburgosurit e sapoardhur duhet të kontrollohen menjëherë nga një mjek ose një infermiere plotësisht e kualifikuar që i raporton një mjeku. E drejta e qasjes në një mjek duhet të përfshijë të drejtën - nëse një emigrant i parregullt dëshiron - për t'u kontrolluar nga një mjek i zgjedhur prej tij/saj; megjithatë, mund të pritët që i paraburgosuri t'i paguajë kostot e një ekzaminimi të tillë.

Njoftimi i një kushëriri ose pale të tretë sipas zgjedhjes vetjake rreth masës së paraburgimit lehtësohet në masë të madhe nëse emigrantët e parregullt lejohen të mbajnë telefonat e tyre mobilë gjatë privimit të lirisë ose së paku të kenë qasje në ta.

83. Përveç këtyre tri të drejtave themelore, traktatet ndërkombëtare njohin të drejtën e një migranti të parregullt të ndaluar që të kërkojë ndihmë konsullore. Megjithatë, mbasi jo të gjithë emigrantët e parregullt mund të duan t'i kontaktojnë autoritetet e tyre shtetërore, ushtrimi i kësaj të drejte duhet t'i lihet personit në fjalë.

84. Është me rëndësi që emigrantëve të sapoardhur të parregullt t'u jepet menjëherë informacion mbi këto të drejta në gjuhën që e kuptojnë. Për këtë qëllim, atyre duhet t'u ofrohet sistematikisht një dokument që shpjegon procedurën e zbatueshme për ta dhe përcaktimin e të drejtave të tyre në terma të qartë dhe të thjeshtë. Ky dokument duhet të jetë në dispozicion në gjuhët që fliten më së shpeshti nga të ndaluarit dhe, nëse është e nevojshme, duhet të përdoren për shërbimet e një përkthyesi.

Masat mbrojtëse të përgjithshme gjatë privimit nga liria

85. Çdo rast i privimit të lirisë duhet të mbulohet nga një urdhër i duhur për paraburgim individual, gjithmonë në dispozicion në institucionin kur personi në fjalë është duke u mbajtur, dhe urdhri i ndalimit duhet të hartohet në fillim të privimit nga liria ose sa më parë pas kësaj. Kjo kërkesë themelore vlen edhe për emigrantët e parregullt që privohen nga liria. Më tej, masat mbrojtëse themelore të personave të ndaluar nga agjencitë e zbatimit të ligjit përforcohen nëse nga një dosje e vetme dhe gjithëpërfshirëse kujdestarie mbahet për secilin person të tillë, duke regjistruar të gjitha aspektet e mbajtjes së tij/saj dhe të gjitha veprimet e ndërmarra në lidhje me këtë.

86. Emigrantët e parregullt të ndaluar duhet të përfitojnë nga një mjet efektiv juridik i cili u lejon që ligjshmëria e privimit të tyre nga liria të vendoset sa më parë nga një organ gjyqësor. Ky shqyrtim gjyqësor duhet të përfshijë një seancë gojore me ndihmë juridike, të ofruar falas për personat që nuk kanë mjete të mjaftueshme, dhe me përkthim (po qe nevoja). Për më tej, emigrantët e parregullt të ndaluar duhet të informohen shprehimisht për këtë mjet juridik. Nevoja për vazhdimin e paraburgimit duhet të rishikohet periodikisht nga një autoritet i pavarur.

87. Duhet të bëhen marrëveshje që u mundësojnë emigrantëve të ndaluar të parregullt për t'u konsultuar me një avokat ose një mjek në vazhdimisht dhe të pranojnë vizita nga përfaqësues të OJQ-ve, anëtarë të familjes ose persona të tjerë sipas zgjedhjes së tyre, si dhe të kenë kontakte telefonike me ta.

Nëse anëtarët e të njëjtës familje janë të privuar nga liria në bazë të legjislacionit për të huajt, duhet të bëhet çdo përpjekje për të mos i ndarë.

88. Është në interes të emigrantëve dhe të stafit që të ketë rregulla të qarta shtëpiake për të gjitha objektet e ndalimit, dhe kopje të rregullave duhet të vihet në dispozicion në një varg gjuhësh të përshtatshme. Rregullat e shtëpisë së pari duhet të jenë informative në natyrë dhe të trajtojnë një gamë sa më të gjerë çështjesh, të drejtash dhe detyrash të rëndësishme për jetën e përditshme në ndalim. Rregullat e shtëpisë duhet të përmbajnë procedura disiplinore dhe t'u ofrojnë të burgosurve të drejtën për t'u dëgjuar për çështjen e shkeljeve që dyshohet se i kanë kryer, si dhe të apelojnë te një autoritet i pavarur kundrejt sanksioneve të vendosura. Pa rregulla të tilla, ekziston rreziku i zhvillimit të një sistemi disiplinues jozyrtar (dhe të pakontrolluar).

Në rastin e zbatimit të një mase të segregacionit për arsye sigurie ose për mbrojtjen e vetë migrantit të parregullt, këto procedura duhet të shoqërohen me masa mbrojtëse efektive. Personi në fjalë duhet të informohet për arsyet e masës së marrë ndaj tij/saj, t'i jepet mundësia të paraqesë pikëpamjet e tij/saj për këtë çështje para se masa të zbatohet, dhe të jetë në gjendje ta kundërshtojë masën para një autoriteti përkatës.

89. Monitorimi i pavarur i objekteve të paraburgimit për emigrantët e parregullt është një element i rëndësishëm në parandalimin e keqtrajtimit dhe, më përgjithësisht, të sigurimit të kushteve të kënaqshme të paraburgimit. Për të qenë plotësisht efektiv, monitorimi i vizitave duhet të jenë i shpeshtë dhe pa paralajmërim. Për më tej, organet monitoruese duhet të fuqizohen për t'i intervistuar emigrantët e parregullt privatisht dhe duhet të shqyrtojnë të gjitha çështjet që lidhen me trajtimin e tyre (kushtet materiale të paraburgimit, dosjet e ndalimit dhe dokumentacionin tjetër, ushtrimin e të drejtave të personave të ndaluar, kujdesi shëndetësor, etj).

Masat mbrojtëse të lidhura me shëndetin

90. Vlerësimi i gjendjes së shëndetit të emigrantëve të parregullt, gjatë privimit të tyre nga liria është përgjegjësi e rëndësishme në lidhje me çdo të ndaluar individual dhe në lidhje me një grup emigrantësh të parregullt si një e tërë. Shëndeti mendor dhe fizik i emigrantëve të parregullt mund të ndikohet negativisht nga përvojat e mëparshme traumatike. Për më shumë, humbja e një mjedisi të njohur personal dhe kulturor dhe pasiguria për të ardhmen vetjake mund të çojë në dëmtime mendore, duke përfshirë acarimin e simptomave të mëparshme të depresionit, ankthit dhe çrregullimeve post-traumatike.

91. Minimalisht, një person me kualifikim të njohur infermerik duhet të jetë i pranishëm përditë në të gjitha qendrat për emigrantët e parregullt të ndaluar. Një person i tillë duhet të kryejë veçanërisht ekzaminimin fillestar mjekësor të të ardhurve të rinj (në veçanti për sëmundje të transmetueshme, përfshirë tuberkulozin), të marrë kërkesat vizita mjekësore, të sigurojë ofrimin dhe shpërndarjen e barnave të përshkruara, të mbajë dokumentacionin mjekësor dhe të mbikëqyrë kushtet e përgjithshme të higjienës.

92. Natyrisht, konfidencialiteti mjekësor duhet të respektohet në të njëjtën mënyrë si në komunitetin e jashtëm; veçmas, dosjet mjekësore të emigrantëve të parregullt nuk duhet të jenë në dispozicion të stafit jomjekësor, por përkundrazi duhet të mbahen të kyçura nga infermierja ose mjeku. Për më shumë, të gjitha kontrollet mjekësore duhet të kryhen jashtë seancës dëgjimore dhe - nëse mjeku në fjalë nuk kërkon ndryshe në rast të veçantë - larg sysh të stafit të kujdestarisë.

Kurdo që anëtarët e stafit mjekësor dhe/ose të infermiereve nuk janë në gjendje të bëjnë një vlerësim të duhur diagnostik për shkak të problemeve të gjuhës, ata duhet të jenë në gjendje të përfitojnë pa vonesë nga shërbimet e një përkthyesi të kualifikuar. Më tej, emigrantët e arrestuar të parregullt duhet të jenë plotësisht të informuar lidhur me trajtimin që u ofrohet.

Tri masa mbrojtëse të tjera të rëndësishme

93. Ndalimi i torturës dhe i trajtimeve a dënimeve çnjerëzore ose poshtëruese përfshin detyrimin për të mos e dërguar një person në një vend ku ka arsye serioze për t'u besuar se ai ose ajo do të jetë në rrezik real nga tortura ose format e tjera të keqtrajtimit. Kështu, emigrantët e parregullt duhet të kenë qasje në procedurë azili (ose procedurë tjetër qëndrimi), që u garanton edhe konfidencialitetin edhe një analizë objektive dhe të pavarur të gjendjes së të drejtave të njeriut në vende të tjera; duhet të kryhet një vlerësim individual i rrezikut të keqtrajtimit, në rastin e deportimit në vendin e origjinës ose në një vend të tretë. KPT-ja shqetësohet se në disa vende afati kohor për dorëzimin e aplikacioneve për azil është i kufizuar me ligj për një numër ditësh nga data e mbërritjes në shtet ose në qendrën e paraburgimit; aplikimet e dorëzuara pas afatit nuk merren parasysh. Një qasje e tillë e rrit mundësinë e personave që të dërgohen në një vend ku i ekspozohen rrezikut real për t'iu nënshtruar torturës ose formave të tjera të keqtrajtimit.

94. Në këtë kontekst, KPT-ja ka dyshime të mëdha mbi politikën e miratuar nga disa vende të përgjimit, në det, të anijeve që transportojnë emigrantë të parregullt dhe të kthimit të personave në fjalë në Afrikën e Veriut ose Veriperëndimore. Një praktikë me pasoja të ngjashme me gjasë zhvillohet në disa kufij të caktuara tokësorë të Evropës.

Vendet që zbatojnë politika ose praktika të tilla mund të jenë në rrezik të shkeljes së parimit themelor të "moskthimit", një parim ky që është pjesë e të drejtës ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, si dhe të drejtës së Bashkimit Evropian. Kështu është veçanërisht kur vendet në të cilat dërgohen emigrantët e parregullt nuk e kanë ratifikuar ose nuk aderojnë në Konventën e Gjenevës të vitit 1951 lidhur me Statusin e Refugjatëve.

95. Në përputhje me Njëzet udhëzimet e kthimit të detyruar të miratuara nga Komiteti i Ministrave më 4 maj 2005, urdhrat e largimit duhet të lëshohen në çdo rast individual në bazë të një vendimi që ndjek ligjet dhe procedurat shtetërore, dhe në përputhje me detyrimet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Urdhri i largimit duhet t'i dorëzohet me shkrim personit në fjalë. Për më tej, duhet të ketë mundësi për apelim kundër urdhrat, dhe deportimi nuk duhet të kryhet para se të jetë dorëzuar vendimi për çdo ankesë. Edhe ndihma e një avokati dhe një përkthyesi duhet të garantohen në këtë fazë të procedurës.

96. Së treti, sa i përket cilitdo vend ku personat privohen nga liria nga një autoritet publik, KPT-ja vazhdimisht rekomandon që çdo shenjë dëmtimi në një person që pohon keqtrajtim, si dhe deklaratat përkatëse të bëra nga personi në fjalë dhe konkluzionet e mjekut (për shkallën e përputhshmërisë mes deklaratës së personit dhe lëndimeve të vërejtura), të regjistrohen rregullisht nga mjeku në një formë të hartuar për këtë qëllim. Një regjistër i ngjashëm duhet të bëhet madje edhe në mungesë të një pretendimi specifik, kur ka arsye të besohet se keqtrajtimi mund të ketë ndodhur. Duhet të ketë procedura për t'u siguruar që çdoherë kur regjistrohen lëndime nga mjeku që janë konsistente me pohimet për keqtrajtim të bëra nga personi në fjalë (ose të cilat, edhe në mungesë pretendimi, qartazi tregojnë për keqtrajtim), sistematikisht të sillet regjistri në vëmendjen e autoriteteve kompetente gjyqësore ose paditëse.

Masa mbrojtëse shtesë për fëmijët

97. KPT-ja konsideron se duhet bërë çdo përpjekje për të shmangur përdorimin e privimit prej lirisë së një mërgimtari të parregullt që është i mitur.⁶ Duke ndjekur parimin e "interesit më të mirë të fëmijës", siç saktësohet në nenin 3 të Konventës së Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijës, ndalimi i fëmijëve, duke përfshi fëmijët e pashoqëruar dhe të ndarë, justifikohet rrallë dhe, sipas mendimit të Komitetit, me siguri nuk mund të motivohet vetëm nga mungesa e statusit të qëndrimit.

Kur, me përjashtime, një fëmijë ndalohet, privimi nga liria duhet të bëhet për periudhë sa më të shkurtër kohore; duhet të bëhen të gjitha përpjekjet për ta mundësuar lirimin e menjëhershëm të fëmijëve të pashoqëruar ose të ndarë nga një qendër paraburgimi dhe vendosjen e tyre në kujdes më të përshtatshëm. Për më tej, për shkak të natyrës së ndjeshme të fëmijës, masat mbrojtëse shtesë duhet të zbatohen kur fëmija ndalohet, veçanërisht në ato raste kur fëmijët ndahen nga prindërit ose kujdestarët e tjerë, ose janë të pashoqëruar, pa prindër, kujdestarë ose të afërm.

98. A Sa më shpejt pas prania e një fëmije t'i bëhet e ditur autoriteteve, një person i kualifikuar profesionalisht duhet të kryejë një intervistë fillestare, në një gjuhë që fëmija e kupton. Duhet të bëhet një vlerësim për mangësitë e veçanta të fëmijës, duke e parë edhe nga pikëpamja e moshës, shëndetit, faktorëve psiko-socialë dhe nevojave të tjera të mbrojtjes, përfshirë ato që rrjedhin nga dhuna, trafikimi ose trauma. Fëmijët e pashoqëruar ose të ndarë, të privuar nga liria, duhet të pajisen me qasje të shpejtë dhe të lirë në ndihmë ligjore dhe të tjera ndihma të përshtatshme, duke përfshirë këtu caktimin e një kujdestari ose përfaqësuesi ligjor. Mekanizmat shqyrtues duhet të vihen në punë për ta monitoruar cilësinë e vazhdueshme të kujdestarisë.

⁶ Në rast pasigurie nëse një migrant i parregullt i caktuar është i mitur (p.sh. nën 18 vjeç), personi në fjalë duhet të trajtohet si të ishte i mitur, derisa e të provohet e kundërta. "Fëmijët e pashoqëruar" (të quajtur edhe të miturit e pashoqëruar) janë fëmijë që janë ndarë nga të dy prindërit dhe të afërmit e tjerë dhe që nuk janë duke nën kujdesin e ndonjë të rrituri i cili, sipas ligjit ose zakonisht, është përgjegjës për kujdestari ndaj tyre. "Fëmijët e ndarë" janë fëmijët e ndarë nga të dy prindërit, ose nga kujdestari i tyre i mëparshëm ligjor ose zakonisht primar, por jo domosdoshmërisht nga të afërmit e tjerë. Këto prandaj mund të përfshijnë fëmijët e shoqëruar anëtarë të tjerë të rritur të familjes.

99. Duhet të ndërmerren hapa për të siguruar një prani të rregullt dhe kontakt individual me një punonjës social dhe një psikolog në institucione që mbajnë fëmijë në paraburgim. Stafi me të dyja gjinitë është garanci kundër keqtrajtimit; prania e stafit të gjinisë mashkullore dhe femrore mund të ketë një efekt pozitiv në kuptimin e etosit të kujdestarisë dhe të nxisë një shkallë normaliteti në një vend ndalimi. Fëmijëve të privuar nga liria duhet t'u ofrohen një varg aktiviteteve konstruktive (me theks të veçantë në mundësimin një fëmije për ta vazhduar shkollimin).

100. Për ta kufizuar rrezikun e shfrytëzimit, duhet të bëhen rregullime të veçanta për ambiente banimi që janë të përshtatshme për fëmijët, për shembull duke i ndarë ata nga të rriturit, përveç nëse konsiderohet në interesin më të mirë të fëmijës të mos bëhet kjo. I këtillë, për shembull, do të ishte rasti kur fëmijët janë në shoqërinë e prindërve ose të afërmeve të tjerë të afërt. Në këtë rast, duhet të bëhet çdo përpjekje për ta shmangur ndarjen e familjes.